

LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Lloji i diplomës “Master Shkencor “

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, i ndryshuar, Bashkia Delvinë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

1(Një) -Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit

(- Kategoria: III-2)

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE 29.04.2026

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË 04.05.2026

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin/et si më sipër është:

1. Drejton, studion dhe zbaton strategjitë dhe politikat në fushën e Sektorit të Planifikimit të Territorit.
2. Organizon dhe ndjek punën, detyrat e ngarkuara brenda sektorit dhe në lidhje me drejtoritë e tjera.
3. Organizon punën studimore dhe propozon për masat konkrete në drejtim të mbarëvajtjes së problemeve.
4. Organizon dhe ndjek punën për koordinimin e kërkesave të subjekteve juridike apo fizike me startegjine zhvillimit urban të qytetit.
5. Raporton pranë INSTAT çdo tre muaj për lejet e ndërtimit..
6. Rakordon punën me Zyren e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës për hartimin e procedurës së regjistrimit të tokës bujqësore.
7. Informon rregullisht Inspektoriatin Vendor në lidhje me lejet e dhëna dhe vë në dispozicion projektin e zbatimit.
8. Bashkepunon me Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sëparë për procedurat e regjistrimit të pronave si dhe saktësimin apo korigjimin e dokumentacionit që përcillen tek kjo e fundit.
9. Ndjek procedurë e aplikimit për Leje Zhvillimi /Ndërtimi etj.
10. Informon në mënyrë periodike eprorin direkt për problemet e ndryshme në fushën e e planifikimit të territorit.
11. Është pjesë e takimeve dhe organizimeve në rastet e nderhyrjeve emergjente si pjesë e komisionit të Emergjencave Civile.
12. Ndjek detyrat e dhëna nga eprori direkt dhe raporton për to.
13. Harton projekte dhe preventiva duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, në kategorinë” III “ ;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” apo “Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike” në Shkencat Inxhinjerike dhe Shkencat Arkitekturore. Diploma e nivelit Bachelor te jete ne te njejen fushe.

b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

c- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar ;

b - Fotokopje të diplomës dhe listave te notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda dates 29.04.2026.

Bashkia Delvine

Lagjia “Sinan Ballaci “

Rruga “Nazif Haderi “

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **04.05.2026**, Bashkisë Delvine do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të www.bashkiadelvine.gov.al në stenden e Bashkisë Delvine , listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Lidhur me orën dhe vendin e zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë, kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së e-mail nga Bashkia Delvine.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Bashkia Delvine , nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 “Për vetqeverisjes vendore”.
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr.9131, Datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike” i ndryshuar.
- Njohuritë për ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Ligji nr.107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- VKM nr.108, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Totali i pikëveve për këtë vlerësim është 40 pikë , I ndarë në :20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhuara me fushën përkatëse dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëveve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, lista e fituesve e përbërë nga kandidatë që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvinë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2

NGRITJA NE DETYRE

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet

procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Sherbimit Kombëtar të Punesimit dhe stendat pranë Bashkisë Delvine duke filluar nga data 04.05.2026.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë “ IV “.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” apo “Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike” në Shkencat Inxhinjerie dhe Shkencat Arkitekturore Diploma e nivelit Bachelor të jete në të njëjten fushe
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.
- c- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar;
- b - Fotokopje të diplomës dhe lista e notave (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 04.05.2026.

Bashkia Delvine
Lagjia “Sinan Ballaci “

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 14.05.2026, Bashkia Delvinë do të shpallë në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", faqen zyrtare www.bashkiadelvine.gov.al, në stenden e informimit të Bashkisë Delvine, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta.

Lidhur me orën dhe vendin e zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së e-mail nga Bashkia Delvine.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Bashkia Delvinë, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohurite mbi Ligjin nr. 139, dt.17.12.2016 "Për vetqeverisjes vendore".
- Njohurite mbi Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar .
- Njohurite mbi Ligjin nr.9131, Datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike" i ndryshuar.
- Njohuritë për ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
- Ligji nr.107/2014 "Për planifikimin dhe Zhvilimin e Territorit".
- VKM nr.108, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, lista e fituesve e përbërë nga kandidatë që kanë grumbulluar mbi 70 pikë, të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë do të shpallet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë www.bashkiadelvine.gov.al dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike nga Bashkia Delvinë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit në portalin “ Shërbimi Kombëtar i Punësimit “ në faqen zyrtare të Bashkisë Delvinë si dhe në stendat e informimit të Bashkisë Delvinë :

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin e Shërbimit të Punësimit “ duke filluar nga data 14.05.2026.